

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Mr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Gani Avdiu e Gëzim Llulluni anëtarë, në çështjen juridike të paditësve Z.A-A., D. A.- N., Y.H., H.H. dhe S.H., që të gjithë nga fsh.... K.Ferizaj, të cilët me autorizim i përfaqëson S.K. avokat nga Lipjani, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim i përfaqëson A.L., Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim B.M. dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson V.H., duke vendosur në çështjen kontestimore të shpërblimit të dëmit të paditësve, duke vendosur sipas ankesës së të paditurave, të paraqitura kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. 67/09 të dt.13.09.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 30.03.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së të paditurës, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.67/09 i dt.13.09.2013, vetëm sa i përket kamatës dhe shpenzimeve të procedurës, dhe gjykohet: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë prej datës 13.09.2013 e deri te pagesa e plotë, DETYROHEN të paditurat që për shpenzimet e procedurës tu paguajnë paditësve shumën prej 3843.80 €, kurse REFUZHET shuma për shpenzimet prej 721.56 €, ndërsa sa i përket pjesës tjetër ankesat e të paditurave REFUZHEN si të pathemelta, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. 67/09 i datës 13.09.2013, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Rrethanat e çështjes:

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar është miratuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve Z.A. nga fsh...., D.N. nga fsh...., Y.A. nga fsh...., H.H. dhe S.H. nga fsh.... K.Ferizaj, si e bazuar dhe detyrohen të paditurat Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë që solidarisht paditësve t’ua kompensojnë dëmin e shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të dt.26.02.2008, në rrugën magjistrale Prishtinë – Ferizaj, të udhëkryqi i rrugës së Reçakut, si vijon: I/a Dëmin jomaterial – moral, paditësve H.H., Z.A., D.N., Y.A. dhe S.H. për dhimbjet shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit – babait të tyre, secilit veç e veç, shumën nga 5000€. I/b. Dëmin material, për shpenzimet e varrimit shumën prej 295€, shpenzimet e pritjes së njerëzve për ngushëllime shumën prej 1400€, për ngritjen e përmendores mbi varr, shumën prej 750€. Në pikën II., të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar janë detyruar të

paditurat që shumat e gjykuar për dëmin si në pikën I/a dhe I/b, paditëseve t'ua kompensoj me kamatë vjetore në lartësinë prej 4.5%, nga data e ushtrimit të padisë 10.03.2009, e deri në pagesën definitive si dhe t'ua kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 4.565.36€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kërcenim të përmbarrimit me dhunë. Në pikën III., është refuzuar kërkesëpadia e paditësve për dëmin jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit – babait mbi shumën e gjykuar prej 5000 deri 7000€, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur të paditurat, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit që të aprovoj ankesën si të bazuar, Aktgjykimin e shkallës së parë të anuloj si joligjor, padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ose lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pala paditëse nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesat e të paditurave janë pjesërisht të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me dt.26.02.2008, rreth orës 03:15h, në magjistralen Prishtinë-Ferizaj të udhëkryqi i rrugës së Reçakut është shkaktuar aksidenti i rëndë i komunikacionit me pjesëmarrjen e tri automjeteve motorike dhe atë Kamionit “Mercedes” të cilin e ka drejtuar Imer Burrniku, veturës “Mercedes 201” të cilën e ka drejtuar i ndjeri N.M. dhe autoveturës “BMW 5/1” të cilën e ka drejtuar K.B.. Aksidenti i komunikacionit është shkaktuar kur automjeti transportues “Mercedes” duke lëvizur nga drejtimi i Kaçanikut në drejtim të Ferizajit me të arritur në udhëkryqin e rrugës së penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion dhe në atë moment nga drejtimi i kundërt ishte duke qarkulluar vetura “Mercedes” me një shpejtësi të madhe ku pas tentimit për frenim është goditur me automjetin transportues, ku për pasojë kanë vdekur vozitësi dhe bashkudhëtari i veturës “Mercedes”. Mbrapa veturës “Mercedes” ka qenë duke lëvizur vetura “BMW”, në të cilën bashkudhëtar ka qenë i ndjeri I.H.. Drejtuesi i veturës “BMW” ishte duke qarkulluar në drejtimin Prishtinë-Ferizaj, mbrapa veturës “Mercedes” ashtu që kur e ka pa rrezikun ka filluar të frenoj veturën e tij duke lënë gjurmët në gjatësi prej 30.25m, për një moment ikë në të majtë të drejtimit të lëvizjes, del jashtë rrugës dhe përplasat në një veturë të një depoje të veturave të dëmtuara, ku për pasojë merre lëndime të rënda trupore i ndjeri I.H., i cili më pas është dërguar urgjentisht në QKUK-Prishtinë, ka qenë në gjendje të rëndë-në komë dhe si pasojë ka vdekur me dt.30.06.2008. Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, është zhvilluar procedurë penale kundër vozitësit të kamionit – I.B., ku Gjykata e Qarkut në Prishtinë në ri procedurë me aktgjykimin P.nr.414/11 të dt.02.04.2012, e ka shpallur fajtor duke e dënuar me burg

në kohëzgjatje prej 3 viteve. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me aktgjykimin e Gjykatës Supreme AP.nr.330/12 të dt.03.10.2012. Kamioni “Mercedes” ka qenë i siguruar të KS “S.” në bazë të kontratës për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, vetura “Mercedes” nuk ka pasur mbulesë siguruese, ndërsa vetura “BMW” ka qenë e siguruar të KS “D.i”-tani KS “...”. Kjo gjendje faktike është konstatuar në bazë të raportit të aksidentit, raportit të hetuesit, aktgjykimit penal P.nr.414/11, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, certifikatës – vërtetimit për vdekje MA08-148 të lëshuar nga Departamenti i Drejtësisë – Zyra e Ekzaminimit Mjekësor. Për shkak të vdekjes të ndjerit I.H., paditësit kanë humbur bashkëshortin dhe babain e tyre, kanë pasur shpenzime për varrimin e tij sipas rregullave të besimit islam, kanë pasur shpenzime për pritjen e njerëzve për ngushëllime dhe shpenzime për ngritjen e përmendores mbi varrin e të ndjerit. Gjykata e shkallës së parë duke marrë për bazë ekspertimet e kryera në këtë çështje lidhur me përgjegjësinë e pjesëmarrësve dhe lëshimet e të siguruarve të të paditurave në këtë aksident në të cilin ka pësuar tani i ndjeri I.H., ka gjetur se sipas përfundimeve të nxjerra në këto ekspertiza aksidenti i shkaktuar për shkak të lëshimeve primare të vozitësit të automjetit transportues “Mercedes”, ndërsa me lëshime sekondare i kanë kontribuar edhe drejtuesit e automjetit “Mercedes 201” dhe “BMW”. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se tani më i ndjeri kishte cilësinë e bashkudhëtarit, kurse vdekja e tij nga ekspertimi i kryer me ekspertizën mjeko-ligjore, ka ardhur si pasojë e lëndimeve trupore të pësuar në aksidentin e komunikacionit të dt.26.02.2008. Gjykata e shkallës së parë më tutje ka gjetur se paditësve iu takon shpërblymi i dëmit jo material dhe material për humbjen e bashkëshortit, përkatësisht babait të tyre duke gjykuar shumat si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë. Duke vendosur lidhur shpenzimet e procedurës ka caktuar shumën prej 4.565,36€, ndonëse me parashtresën e të autorizuarit të paditësve kjo shumë ishte kërkuar në vlerën prej 3.843,80€.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur “.

Neni 195.1 i LPK: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:e) ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë “.

Neni 201 i LPK: “Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes kryesore drejtpërdrejtë, me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, po që se konstaton se ekziston ndonjëri nga këto shkaqe të treguara në ankesë: e) nëse ka konstatuar se me aktgjykimin e shkallës së parë është tejkaluar kërkesëpadia ashtu që me të është pranuar me tepër se që është kërkuar me padi”.

Neni 206 par 1 i LMD: “Për dëmin të cilin disa persona e kanë shkaktuar bashkërisht, përgjigjen të gjithë pjesëmarrësit solidarisht”.

Neni 178 par 4 i LMD: “Për dëmin që e kanë pësuar personat e tretë zotëruesit e automjeteve përgjigjen solidarisht”.

Neni 201 par 1 i LMD: “Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’u gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit) kompensim të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore”.

Neni 193 par 1 i LMD: “Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t’i kompensojë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nuk qëndrojnë pasi nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore. Kolegji vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 182 par.2 të LPK-së për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kolegji i gjykatës së shkallës së dytë nuk i akcepton për faktin se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet vendimtare dhe në këtë çështje nuk ka pretendime ankimore në drejtim të gjendjes faktike se flasin fakte të reja apo prova të reja.

Sipas vlerësimit të kolegjit gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet në mënyrë të pjesshme. Kolegji i Gjykatës së shkallë së dytë ka vlerësuar, se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka akorduar shumat lidhur me dëmin, shumat e gjykuara i përgjigjen kategorive të dëmit të shkaktuar dhe paraqesin satisfaksion për to, andaj edhe ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës, se shumat e gjykuara janë të larta dhe nuk përkojnë më dëmin e pësuar. Gjkata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur në këtë çështje ka gjetur se të paditurat përgjigjen në mënyrë solidare pasi që dëmi është shkaktuar në të njëjtën kohë nga veprimet e të siguruarve të të paditurave, përkatësisht sigurimeve të detyruara për të paditurën e tretë. I ndjeri kishte cilësinë e bashkudhëtarit, kurse bazuar në nenin 178 të LMD, për dëmin e shkaktuar ndaj personave të tretë, drejtuesit e automjeteve janë përgjegjës solidarë, çka nënkupton përgjegjësinë e të paditurave, lidhur me shpërblimin e dëmit mbi bazën e rregullave të të drejtës sigurimore nga auto përgjegjësia. Lidhur me kontestimet e të paditurave lidhur me shkallën e përgjegjësishë për kontributin e të siguruarve të tyre në aksidentin e komunikacionit, Kolegji vlerëson se kjo çështje mund të bëhet objekt i regresimit të debitorëve solidar në të ardhmen varësisht prej rrjedhës së procedurës lidhur me këtë çështje kontestimore. Për këto arsye edhe në këtë pjesë kjo gjykatë e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Megjithatë Gjykata e Apelit ka aprovuar pjesërisht ankesën e palës së paditur në pjesën sa i përket lartësisë së kamatës, duke e gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që në rastin konkret caktimi i të njëjtës bëhet, me

kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë prej datës 06.03.2013 e deri te pagesa e plotë, në kuptim të dispozitave të nenit 277 të LMD.

Gjykata e shkallës së dytë ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë në pjesën sa i përket shpenzimeve të procedurës në kuptim të nenit 201 të LPK, duke pranuar shumën në lartësi prej 3843.80 € në vend të asaj prej 4.565,36 € sa ishin të miratuara me aktgjykimin e atakuar, pasi që gjykata e shkallës së parë lidhur me të njëjtat, i ka pranuar më shumë se sa i kishte kërkuar i autorizuari i paditësve me parashtrësën për paraqitjen e listës së shpenzimeve të datës 18.09.2013.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194 dhe 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3848/13, me dt.30.03.2016

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Mr.sc. Rafet Haxhaj